



**Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 348/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1300(njëmijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 25. 10. 2013 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 23 tetor 2013 në rrugën Agim Ramadani anëtarët e subjektit politik PDK kanë vendosur në rrithojat e konvikteve të studentëve posterat e kandidatit për asamble komunale nga ky subjekt politik Migjen Shala. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografat nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 28.10.2013, ora 10:00.

PZAP-i sipas afatit të paraparë pra me datën 28.10.2013 pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza dhe se sipas të dhënave që kanë nga tereni persona të paidentifikuar kanë vendosur posterat e kandidatit në fjalë me qëllim të dëmtimit të partisë, andaj sipas PDK-së edhe përkundër kësaj me të kuptuar për këtë posterët janë hequr menjëherë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresave të lëndës, shihet qartë se si posterat e kandidatit të PDK-së Migjen Shala janë të vendosura në objektet publike ,e për

të cilin veprime subjekti politik PDK konsiderohet përgjegjës pasi që këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, për këtë mori parasysh si rrrethanat rënduese ashtu edhe rrrethanat lehtësuese. Si rrrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK edhe më parë ka kryer shkelje të natyrës së tillë dhe se konsiderohet si recidivist dhe si rrrethanë tjetër rënduese mori atë se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Prandaj vendosja e posterave e kandidatëve të saj në objektet publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK pas marjes së kërkësës për përgjigjës në ankesë nga PZAP-i, në pajtim me nenin 32.6 të LZP-së ka ndërmarr veprime konkrete duke i larguar menjëherë posterat e kandidatit të saj nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i duke i marr parasysh të gjitha arsyet e lartçekura konstaton se subjekti politik PDK-së ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, me të cilat ndalohet vendosja e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Prandaj PZAP-i, në mbështetje të nenit 118.1 dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa**

Anr. 348/2013 më datën 31.10.2013.



#### **Këshillë juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkësat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.